

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.A. nga fshati . -Komuna e Kuksit Republika e Shqipërisë, për shkak të dy veprave penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në tentativë nga neni 327 par.2 nënpar.1.1 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, i akuzuar sipas akuzuarve të Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm me numër PP/II.nr.1385/18 të datës 20.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar **me datën 03.12.2018**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të dëmtuarit S. B. , të akuzuarit A.A. si dhe mbrojtësit e tij av.A. R.nga Gjakova, me datën **07.12.2018** mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.A., nga i ati S. e ëma L., e gjinisë H data e linjdes..., në fshatin . Komuna e Hasit, Republika e Shqipërisë, tani me vendbanim në fshatin Liqe i Kuq, Komuna e Kukësit, Republika e Shqipërisë, i martuar baba i 5 (pesë) fëmijëve, ka të kryer katër vite të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Shqipërisë, gjendet në paraburgim nga data 17.09.2018 në ora 15:30 minuta.

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Sepse me datën 28.12.2016, në orët e hershme të mëngjesit, në fshatin . Komuna e Gjakovës, pikërisht në objektin fetar tyrbja e “B.D. ”, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit S.B. i kujdestar të tyrbes, në atë mënyrë që, I pandehuri duke shfrytëzuar momentin e përshtatshëm, kurë ka lëvizje të pakta të qytetarëve duke përdorur forcën, me pajser fillimisht hap dritaren e tyrbes, hyn Brenda në objektin në kërkim të parave dhe gjerave tjera me vlerë thyen drynin (katinarin) në të cilën lihen paratë e grumbulluara (nezret) nga e cila merr një sasi të parave, të cilat janë tubuar nga besimtarët, e më pas largohet në drejtim të panjohur me çka të dëmtuarave ju ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material rreth 150 Euro sipas deklaratës së tyre.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë 327 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

II. Sepse me datën 15.09.2018, në orët e vona të pas natës, në fshatin . Komuna e Gjakovës, pikërisht në objektin fetar tyrbja e “Sh.R.”, me qëllim të pavarësimit të kundërligjshëm për vete, tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarës R. Sh. Sh. , kujdestare e tyrbes, në atë mënyrë që i pandehuri duke shfrytëzuar momentin e përshtatshëm, kurë ka lëvizje të pakta të qytetarëve duke përdorur forcën, fillimisht hap dritaret e tyrbes, hyn brenda në objekt në kërkim të parave dhe gjerave tjera me vlerë thyen drynin (katinarin) në të cilën lihen paratë e grumbulluara (nezrat) nga e cila merr një sasi të parave, të cilat janë tubuar nga besimtarët, e më pas largohet në drejtim të panjohur me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë 327 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

III. Sepse me datën 15.09.2018, në orët 03:30 minuta, të mëngjesit, në fshatin . Komuna e Gjakovës, saktësisht në objektin fetar tyrbja e “B.D.”, me qëllim të pavarësimit të kundërligjshëm për vete, tenton ta merr pasurinë e luajtshme në tyrbe, në atë mënyrë që i akuzuari, duke shfrytëzuar momentin e përshtatshëm duke përdor forcën me pajisje dhe kaçavidë (shafsniger), fillimisht tenton ta hap dritaren e objektit mirëpo për shkak të festes së M. në objekt kanë qenë duke u lutur besimtarët të cilët pasi e kanë vërejtur të pandehurin, kanë dalë jashtë për ta arrestuar mirëpo i pandehuri duke tentuar të ik, tenton ta sulmon me kaçavidë (shafsniger) të dëmtuarin A. Rr. , dhe më atë rast goditet me lopatë nga i pandehuri A. B. .

Me këto veprime ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë në tentativë 327 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75, 76 par.1 nënpar.1.3, 80 dhe nenit 327 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 dhe nenit 28 të KPRK-së, të akuzuarit ia shqipton dënimet si në vijim:

- **Për veprën penale nën.I** të dispozitivit **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.
- **Për veprën penale nën.II** të dispozitivit **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.
- **Për veprën penale nën.III** të dispozitivit **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Andaj gjykata konform nenit 80 të KPRK-së, të akuzuarit e:

G J Y K O N

ME DËNIMIN UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej 2 vite e 9 (nëntë) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 17.09.2018 e tutje, por koha në paraburgim nuk mund të jetë më shumë se sa dënimi i shqiptuar me burgim.

Të dëmtuarit: Tyrbja e “..” dhe “Tyrbja e ..” që të dyja me seli në ... Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari A.A. , që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor shumë prej 50 (pesëdhjetë) Euro, ndërsa në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimin shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (peshmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

VAZHDOHET PARABURGIMI kundër të akuzuarit **A. (S.) A.** nga fshati ...Komuna e Kukësit, Republika e Shqipërisë, deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se koha e shqiptimit të dënimin me burgim në kohëzgjatje 2 vite e 9 (nëntë) muajve, e cila kohë duhet të llogaritet nga data 17.09.2018.2018 e tutje.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i përgjithshëm, pran kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1385/18 të datës 20.11.2018, kundër të akuzuarit A.A. nga fshati ...Komuna e Kuksit Republika e Shqipërisë, për shkak të dy veprave penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në tentativë nga neni 327 par.2 nënpar.1.1 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës, kundër të akuzuarit A. A., andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari A.A. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale sipas pikave të aktakuzës, ai ka shtuar se jam konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin tim dhe e pranoj fajësinë për tri veprave penale sipas pikave të aktakuzës , theksoi se jam penduar për këto veprime dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla, por këto veprime i kam bërë për shkak se jam i gjendjes shumë të dobët ekonomike.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, duke dhënë mendimin rreth pranimit të fajësisë nga ana e akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, dhe pasi që i njëjti është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, po ashtu duke marr parasysh faktin se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohen gjendjet faktike sikurse në dispozitiv të aktakuzës dhe se në bazë të po kësaj gjendje faktike përmbushen të gjitha elementet e veprave penale për të cilët akuzohet i pandehuri.

I dëmtuari S.B. deklaroi se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit por si palë e dëmtuar sa i përket ndjekjes penale ia lë në vlerësim gjykatës ndërsa si palë e dëmtuar edhe pse është shkaktuar dëme më i madh ku janë thyer dy dritare unë deklaroj se nuk parashtrojmë kërkesë pasurore-juridike dhe nuk kërkojmë që të më kompensoi dëmin që është shkaktuar me këto vepra penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.A. R.nga Gjakova, duke dhënë mendimin rreth pranimit të fajësisë nga ana e akuzuarit ka deklaruar se: në konsultim me të akuzuarin kemi ardhur në përfundim që të pranojmë fajësinë pasi që konsiderojmë se pranimi i fajësisë do të ketë benifite në shqiptimin e sanksionit penal njëherë lusim gjykatën e nderuar që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese pasi që i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike është mbajtës i 5 anëtarëve të familjes, dhe njëherë ka shprehur keqardhje të thellë për kryerjen e veprave penale a ndaj pranimin e fajësisë i njëjti e bënë me vetëdije dhe vullnet të plotë dhe pa presion andaj edhe i propozoi gjykatës që ta pranon pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari A.A , ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij avA. R., pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë

tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendjet faktike të vërtetuara

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues e ka vërtetuar këto gjendje faktike:

-se i akuzuari A. A., me dashje e ka kryer dy veprat penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I dhe II. të këtij aktgjykimi.

-se i akuzuari A.A. , me dashje e ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë në tentativë nga neni 327 par.2 nënpar.1.1 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin III. të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprave penale

Në nenin 187 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të sulmit e kryen: *“Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, pa pëlqimin e atij personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”*. Ndërsa në nenin 25 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale shkelja e urdhrave mbrojtës e kryen: *“Kush e shkel në tërësi ose pjesërisht urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente kryen veprë penale që dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro deri më dymijë (2000) Euro ose me burgim deri në gjashtë muaj”*.

5. Vendimi për shpalljen fajtor të akuzuarit

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit në dispozitivin I dhe II të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale të nga neni 327 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 të KPRK-së ndërsa në veprimet e të akuzuarit në dispozitivin III të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes së rëndë në tentativë nga neni 327 par.2 nënpar.1.1 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprat penale dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është i pa punë, i gjendje së dobët ekonomike, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij duke i kërkuar publikisht falje palëve të dëmtuara dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë nga ana e të akuzuarit për të gjitha veprat penale për të cilat ngarkohet. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari veprat penale i ka kryer ndaj anëtarëve të familjes përkatësisht fëmijëve të tij, ka ushtruar dhunë në familje, ndërsa si rrethanë posaçërisht rënduese gjykata ka vlerësuar shkallën e lartë të dashjes nga ana e të akuzuarit për

kryerjen e veprave penale ku i njëjti duke qenë i vetishëm se ka pasur të caktuar urdhrin mbrojtës dhe ka qenë i obliguar të respektoj aktvendimin C.nr.527/18 të datës 31.08.2018, të cili i është ndaluar të dëmtuarit F. Du. dhe El. D. , të mos i ofendoj, fyej, nënçmoj, të mos përdorë fjalorë me fjalë të ndyta, të mos i kërcënoj, dhe mos të iu afrohet në distancë prej 10 metrave dhe në distancë në shtëpi ku kanë jetuar të dëmtuarit dhe në distancë prej 50 metra në vendet publike, mirëpo i njëjti edhe përkundër këtij urdhri i vetëdijshëm e ka shkalur të njëjtin duke kryer edhe vepra penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin unik të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së, ka vendosur që të dëmtuarin E. (N.) D. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike t'a udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ndërsa të dëmtuarën F.(N.) D., gjykata nuk e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike pasi që e njëjta gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore- juridike ndaj të akuzuarit, nuk kërkon kompensim dëmi.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar vetëm shpenzimet e paushallit gjyqësor duke u bazuar në nenin 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

- Departamenti i përgjithshëm -

P.nr.825/2018, me datë 02.12.2018

**Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.